



FTESË PËR KUOTIM

REFERENCA E PROKURIMIT Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse

EMRI I OFERTUESIT _____

ADRESA:	
---------	--

EMRI DHE ID E NSH-së:	Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, regjionit të Pejës, regjionit të Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse
EMRI DHE NËNSHKRIMI I KRYESUESIT TË AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT:	Miftar Salih  Albert Matoshi 

Natyrë dhe fushështrirja e saktë e nevojës specifike të cilën do të plotësojë prokurimi, është e cekur më poshtë.

AKP është në përfundim e sipër të Projektit për Rregullimin e Lëndës Arkivore të NSH-ve në likuidim. Ky proces përfshin të gjithë arkivin e Ndërmarrjeve Shoqërore që administrohet nga AKP në pesë zyrat rajonale.

Për të transferuar dokumentacionin në Arkivin kompetent, AKP duhet ta bëjë këtë sipas procedurave të Arkivit. Dokumentacioni regjistraturik, i cili dorëzohet, duhet të vendoset në kuti arkivi. Kutitë e arkivit kanë gjerësinë 10 cm dhe lartësinë 35.5 cm.

Numri i kutive arkivit në rajone është si në vijim:

- Rajoni i Prishtinës: 20,592 kuti
- Rajoni i Prizrenit: 7,593 kuti
- Rajoni i Pejës: 8,146 kuti
- Rajoni i Mitrovicës: 5,427 kuti
- Rajoni i Gjilanit: Aktualisht nuk kemi numër të saktë, por duke u bazuar në numrin e madh të NSH-ve që ka, mund të vlerësojmë se i ofrohet rajonit të Prishtinës, me rreth 20,592 kuti.

Transportimi do të bëhet nga depo e arkivit të zyrës rajonale përkatëse në Arkivin kompetent, që përkatësisht do të jetë brenda regjionit. Përveç dokumentacionit të rajonit të Gjilanit, i cili momentalisht gjendet në depon e arkivit të rajonit të Prishtinës, pa i që ky dokumentacion duhet të dorëzohet në Arkivin kompetent në rajonin e Gjilanit.

AKP kërkon angazhimin e një kompanie që do t'i vendosë këto kuti në paketa, të bëjë përshkrimin në paketa se cilës Ndërmarrje i takon, paketat të vendosen në paleta, t'i mbështjellë me folje najloni dhe do ta bëjë transportimin e dokumentacionit në arkivat përkatëse për ruajtje të mëtejshme.

Afatet dhe Kushtet e Furnizimit të Mallrave dhe Shërbimeve

1.	<u>Malli apo Shërbimi i Kërkuar:</u>	Kuota kundrejt Ftesës apo/dhe specifiko/rekomando si të përshtatshme llojin e mallit apo shërbimeve për t'u prokuruar.
2.	<u>Çmimi Fiks:</u>	Çmimet e kuotuar nga Furnizuesi duhet të jenë fikse dhe të mos i nënshtrohen ndryshimeve gjatë përmbushjes së kontratës.
3.	<u>Prejardhja:</u>	Furnizuesi duhet të sigurojë vërtetimin për prejardhjen e mallit.
4.	<u>Kushtet e dërgesës:</u>	Furnizuesi duhet të kuotoj kushtet e dërgesës.
5.	<u>Kushtet e pagesës:</u>	Furnizuesi duhet të cekë kushtet e pagesës. Kushtet e njëjta duhet të ceken edhe në faturën e Furnizuesit. Furnizuesi duhet të cekë qartë nëse çmimi përfshin apo jo TVSh-në.
6.	<u>Garancioni:</u>	Furnizuesi duhet të cekë hollësitë e kushteve dhe afateve të garancionit.
7.	<u>Specifikacionet Teknike në rast të kërkesës së mallit:</u>	Furnizuesi vërteton pajtueshmërinë me specifikat e lartpërmendura. Në rast të devijimeve, Furnizuesi duhet të cekë të gjitha këto devijime kundrejt: (i) Përshkrimin e Përgjithshëm të Mallit të kërkuar, (ii) Detajet specifike dhe standardet teknike të kërkuara, (iii) Parametrat e Kërkuar të Performancës.
8.	<u>Mospërmbushja:</u>	Blerësi mund të aplikoj ndëshkim (penalti) për mos përmbushje të kushteve të kontratës (deri në 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës).